



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Për:** Panelin e Gjykatës së Apelit  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratorja:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 19 shkurt 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i përgjigjes ndaj apelit të Mbrojtjes së Krasniqit kundër vendimit të paraburgimit**

---

**Prokurori i Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Deivid Huper

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Deivid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagendra

## I. Hyrje

1. Në pajtim me nenin 41 të Ligjit<sup>1</sup> dhe rregullat 57 dhe 170 të Rregullores,<sup>2</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) i përgjigjet apelit të KRASNIQIT<sup>3</sup> kundër vendimit<sup>4</sup> që refuzoi kërkesën për lirimin e KRASNIQIT.<sup>5</sup>

2. Paneli i Gjykatës së Apelit (“Paneli”) duhet ta hedhë poshtë apelin e KRASNIQIT në tërësinë e vet. Sikundër parashtrohet me hollësi më poshtë, në vendim: (a) janë zbatuar standardet e duhura ligjore; (b) vlerësimi është individualizuar si duhet; (c) faktorët e tjerë të rrezikut janë peshuar saktë; dhe (d) asnjë kusht nuk i zvogëlon mjaftueshëm rreziqet e identifikuara.

## II. Historiku procedural

3. Më 28 maj 2020, ZPS-ja parashtroi kërkesën për fletarrestime.<sup>6</sup>

4. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi një aktakuzë prej dhjetë pikash kundër të akuzuarit, në të cilën ai akuzohet për një sërë krimesh ndaj

---

<sup>1</sup> Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 (“Ligji”). Përveçse kur përcaktohet ndryshe, të gjitha referencat “neni (nenet)” u referohen neneve të Ligjit.

<sup>2</sup> Rregullorja e Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 (“Rregullorja”). Të gjitha referencat “rregulla” apo “rregullat” këtu i referohen Rregullores, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

<sup>3</sup>Versioni i redaktuar publik i Apelit të Mbrojtjes së Krasniqit kundër vendimit mbi kërkesën e Jakup Krasniqit për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, 3 shkurt 2021 (me shtojcën) (“Apeli i KRASNIQIT”).

<sup>4</sup> Versioni i redaktuar publik i kërkesës së Jakup Krasniqit për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00180/RED, 22 janar 2021 (versioni publik i njoftuar më 26 janar 2021) (“Vendimi”).

<sup>5</sup> Versioni i redaktuar publik i kërkesës për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00122, 7 dhjetor 2020, KSC-BC-2020-06/F00122/RED, 18 dhjetor 2020 (me tri shtojca) (“Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT”).

<sup>6</sup> Versioni i redaktuar publik “Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to”, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005, 28 maj 2020, KSC-BC-2020-06/F00005/ RED, 17 nëntor 2020 (“Kërkesa për fletarrestim”).

njerëzimit dhe për krime lufte, përfshirë vrasje të qëllimshme, zhdukje me forcë të personave, përndjekje, dhe tortura.<sup>7</sup>

5. Po atë ditë, u miratua kërkesa për fletarrestime.<sup>8</sup> I akuzuari u arrestua më 4 nëntor 2020 dhe u transferua në selinë e DHSK-së në Hagë.

6. Më 7 dhjetor 2020, i akuzuari parashtrroi kërkesën për lirimin e KRASNIQIT, e cila u pasua nga përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim<sup>9</sup> dhe kundërpërgjigja e KRASNIQIT lidhur me kërkesën për lirim.<sup>10</sup>

7. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dha vendimin. Ai arriti në përfundimin se ekziston rreziku që i akuzuari të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave para DHSK-së, apo të kryejë krime të tjera kundër personave që pretendojnë se pjesëtarët UÇK-së kanë kryer krime, përfshirë edhe kundër dëshmitarëve që kanë dhënë apo mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që priten të paraqiten para DHSK-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu arriti në përfundimin se nuk ka asnjë kusht që të pakësojë mjaftueshëm rreziqet se i akuzuari mund të pengojë procedurat para DHSK-së, apo të kryejë krime të tjera.

8. Më 3 shkurt 2021, i akuzuari parashtrroi për protokollim apelin e KRASNIQIT kundër këtij vendimi.

---

<sup>7</sup> Version i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, KSC-BC-2020-06/F00026/RED, 26 tetor 2020 (versioni publik i njoftuar më 30 nëntor 2020).

<sup>8</sup> Versioni i redaktuar publik i vendimit për kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2020-06/F00027/RED, 26 tetor 2020 (version publik i njoftuar më 26 nëntor 2020) (“Vendimi për fletarrestime”).

<sup>9</sup> Version i redaktuar publik i përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës në emër të z. Jakup Krasniqi për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00153/RED, 17 dhjetor 2020 (versioni publik i njoftuar më 22 dhjetor 2020) (“Përgjigja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim”).

<sup>10</sup> Versioni i redaktuar publik i kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj përgjigjes të Prokurorisë lidhur me kërkesën për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00163, 6 janar 2021, KSC-BC-2020-06/F00163/RED, 26 janar 2021 (“Kundërpërgjigja e KRASNIQIT lidhur me kërkesën për lirim”).

### III. Standardi i vlerësimit

9. Në dhënien e vendimeve diskrecionale, të tilla si vendimet mbi lirimin e përkohshëm, pesha që u jepet aspekteve me rëndësi mund të varet nga shumë faktorë.<sup>11</sup> Për shkak të natyrës së vendimeve për lirim të përkohshëm, të cilat lidhen me fakte konkrete, paneli i shkallës më të ulët është më mirë në gjendje t'i vlerësojë këta faktorë.<sup>12</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk duhet të ndërhyjë, përveçse kur apeluesi demonstroi ekzistencën e një gabimi të dukshëm, pra nëse vendimi është mbështetur në një gabim ligjor, gabim faktik, apo është keqpërdorur kompetenca diskrecionale.<sup>13</sup> Thjesht mospajtimi me përfundimet e nxjerra nga paneli i shkallës së parë në bazë të fakteve të disponueshme, apo me peshën që ai u ka dhënë faktorëve të caktuar, nuk është i mjaftueshëm për të provuar një gabim të qartë.<sup>14</sup>
10. Pretendimi se bëhet fjalë për një gabim ligjor kërkon identifikimin e gabimit të pretenduar, paraqitjen e argumenteve në mbështetje të pretendimit, dhe shpjegimin se si gabimi e bën vendimin të pavlefshëm.<sup>15</sup> Një pretendim për gabim ligjor, i cili nuk ka gjasa të ndryshojë rezultatin e një vendimi, mund të hidhet poshtë për këtë arsye.<sup>16</sup>
11. Konstatim për gabim faktik mund të bëhet vetëm nëse asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të kishte dalë me konstatimin gjyqësor të kundërshtuar.<sup>17</sup> Në marrjen e

---

<sup>11</sup> *Prokurori kundër Gucatit dhe Haradinajt*, Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, 9 dhjetor 2020, Publik ("Vendimi i apelit të Gucatit"), para. 44, 49.

<sup>12</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.49.

<sup>13</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 14, 49. *Prokurori kundër Gucatit dhe Haradinajt*, Vendim mbi apelin e Nasim Haradinajt që vlerëson paraburgimin, KSC-BC-2020-07/IA002/F00005, 9 shkurt 2021, Publik ("Vendimi i apelit të Haradinajt"), para.14.

<sup>14</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.64.

<sup>15</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.12.

<sup>16</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.12.

<sup>17</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.13.

vendimit nëse një konstatim ishte i arsyeshëm, Paneli nuk i rrëzon me lehtësi konstatimet faktike të bëra nga një panel i një shkalle më të ulët.<sup>18</sup>

12. Për të konstatuar shpërdorim të diskrecionit duhet që vendimi të ketë qenë aq i padrejtë apo i paarsyeshëm sa të përbëjë shpërdorim të diskrecionit nga paneli i shkallës më të ulët.<sup>19</sup>

#### IV. Parashtrime

##### A. JANË ZBATUAR STANDARDET E DUHURA LIGJORE

13. Argumentet në arsyet 1 dhe 4 të apelit të KRASNIQIT duhen refuzuar në tërësinë e tyre.

14. Neni 41(6)(b) i Ligjit kërkon që të ekzistojnë “arsye të artikulueshme për të besuar” se rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) janë vërtetuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se arsyet duhet të jenë “të artikulueshme” në kuptimin që duhet të jenë të përcaktuara me hollësi, që do të thotë se kërkohet arsyetim specifik dhe arsye konkrete për të vendosur vazhdimin e paraburgimit.<sup>20</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu arriti në përfundimin se arsyet specifike të artikulueshme duhet të mbështetin “besimin” se rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) ekzistojnë, duke treguar pranimin e mundësisë, jo të pashmangshmërisë, së ndodhjes së tyre në të ardhmen.<sup>21</sup>

15. Ndonëse ligji përfshin termat “është” dhe “do të” kur përshkruan kriteret e nenit 41(6), këto terma rrethohen nga një gjuhë që e bën të qartë se nuk kërkohet aspak të qenit plotësisht i sigurt.<sup>22</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka nevojë të arrijë në

<sup>18</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.13.

<sup>19</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.14; *Vendimi i apelit të Haradinajt*, KSC-BC-2020-07/IA002/F00005, para.14.

<sup>20</sup> *Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED*, para.18.

<sup>21</sup> *Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED*, para.18.

<sup>22</sup> *Shih*, *Apeli i KRASNIQIT*, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para. 14, 18.

përfundimin se i akuzuari “do të” pengojë hetimin, por përkundrazi ,se “ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar” një gjë të tillë. Është e qartë se “besimi” është një standard më i ulët se siguria dhe se çdo vlerësim i një sjellje të ardhshme përfshin në vetvete vlerësimin e mundësisë dhe të rrezikut.<sup>23</sup>

16. Ky Panel ka nxjerrë tashmë përfundimin se shqyrtimi i liritimit të përkohshëm përfshin vlerësimin e rrezikut.<sup>24</sup> Në veçanti, Paneli arriti në përfundimin se përcaktimi i domosdoshmërisë së paraburgimit ka të bëjë me “mundësinë, jo pashmangshmërinë, e ndodhjes së ngjarjeve të tilla në të ardhmen”.<sup>25</sup> Kjo nuk ishte një referencë e bërë shkarazi sa për të thënë se kërkohet diçka më pak se siguri e plotë; Paneli e formuloi këtë vendim pikërisht me këto fjalë dhe citoi me miratim jurisprudencën e GJPN-së ku përdoret i njëjti formulim.<sup>26</sup>

17. Propozimi i standardeve shtesë apo të ndryshme lidhur me konstatimet që duhet të bëjë Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e çon përpara çështjen.<sup>27</sup> Shkalla e sigurisë së kërkuar rrjedh natyrshëm nga formulimi “arsye të artikulueshme për të besuar” në nenin 41(6)(b). Ky interpretim tashmë është vendosur nga Paneli dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka artikuluar asnjë standard ligjor të papajtueshëm apo të pasaktë.<sup>28</sup>

18. Për sa i takon konkretisht nenit 41(6)(b)(iii), sikurse vëren me të drejtë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, përgjegjësia penale mund të rrjedhë nga forma të ndryshme të të vepruarit. Nuk është e nevojshme të demonstrohet se i akuzuari do ta kryejë personalisht

<sup>23</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para.19.

<sup>24</sup> *Shih*, *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 51, 63, 67, 69.

<sup>25</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.67.

<sup>26</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 67, që citon ICC/GJPN, *Prosecutor v. Mbarushimana*, Judgment on the Appeal of Mr Callixte Mbarushimana Against the Decision of Pre-Trial Chamber I, 19 May 2011, entitled “Decision on ‘Defence Request for Interim Release’”, ICC-01/04-01/10-283, 14 korrik 2011, para. 60.

<sup>27</sup> *Shih*, *Vendimi i apelit të Haradinajt*, KSC-BC-2020-07/IA002/F00005, para. 64 dhe poshtëshënimi 119.

<sup>28</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para. 14-20.

veprimin e fajshëm (*actus reus*) lidhur me krimin ose krimet e parashikuara, për të vërtetuar rrezikun përkatës.<sup>29</sup> Në të vërtetë, një interpretim i tillë do të ishte parodizim i kësaj dispozite.

19. Gjithashtu, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,<sup>30</sup> çka shtrohet për diskutim është pikërisht rreziku, ndër të tjera, i kryerjes së krimeve të tjera të dhunshme. Kërkesa për “krime të ngjashme me veprat penale bazë të paraqitura në Aktakuzë”,<sup>31</sup> e bën të qartë se analiza që duhet të bëjë Gjykatësi i Procedurës Paraprake në bazë të nenit 41(6)(b)(iii) ka të bëjë me krime të rënda.<sup>32</sup> Është e qartë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka konsideruar këtë rrezik të vërtetuar për sa i takon të akuzuarit, duke konstatuar “gjasën” se i akuzuari do të kryejë krime të tilla sipas formave të zbatueshme të përgjegjësisë.<sup>33</sup>

20. Konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se neni 41(6)(b)(iii) përfshin krime të ardhshme të cilat janë të “ngjashme”, por jo domosdoshmërisht duhet të jenë “të njëjta” me krimet bazë për të cilat janë ngritur akuza, nuk përmban asnjë gabim.<sup>34</sup> Hartuesit e ligjit në vitin 2015 e kishin të qartë se çdo konflikt i armatosur apo sulm ndaj popullsisë civile i asaj periudhe juridiksionale tashmë kishte përfunduar dhe nuk do të mund të përdorej për arrestimin e të akuzuarit 15-20 vite pas periudhës së mandatit. Për rrjedhojë, interpretimi i propozuar nga Mbrojtja, e cila kërkon ta kufizojë zbatueshmërinë e kësaj arsyeje për paraburgim vetëm tek veprat penale që lidhen me nenin 15(2),<sup>35</sup> është i pakuptimtë.

---

<sup>29</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 22, 42.

<sup>30</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para.38.

<sup>31</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para. 34-36.

<sup>32</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.42.

<sup>33</sup> Vendimi, KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.42.

<sup>34</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 21, 42. *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001/RED, para.34.

<sup>35</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 37.

21. Sugjerimi se hartuesit janë përpjekur qëllimisht të siguronin ekzistencën e një game më të gjerë arsyesh për paraburgim për personat e akuzuar për vepra kundër administrimit të drejtësisë se sa për personat që akuzohen për krime ndërkombëtare themelore, bie ndesh me kriterin e analizës racionale. Nëse krimet ndërkombëtare për të cilat janë ngritur akuzat duhet të ishin “të njëjta” për të përmbushur kushtet e nenit 41(6)(b)(iii), kjo dispozitë faktikisht do të bëhej e pavlefshme për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krime themelore. Mbrojtja i kushton rëndësi të tepruar përdorimit të trajtës së shquar në togfjalëshin “veprat penale,”<sup>36</sup> duke përjashtuar të gjitha parimet e tjera të interpretimit.<sup>37</sup> I vetmi interpretim i besueshëm i kësaj dispozite – sikundër është pranuar nga Mbrojtja në qëndrimin alternativ të saj<sup>38</sup> – është se nuk kërkohet një përputhje e plotë midis veprave penale. Për këtë arsye, ajo çka duhet të bëjë Gjykatësi i Procedurës Paraprake është që të vlerësojë gjasat që i akuzuari, nëse lirohet, do të përfshihet apo do të kontribuojë, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë penale, në kryerjen e krimeve të ngjashme me veprat penale bazë për të cilat akuzohet.<sup>39</sup> Sikundër konstatohet më lart, diskutimi shtrohet pikërisht për këto lloj krimesh, për të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake, konstatoi se ekzistonte rreziku që të ndodhnin.

22. Për më tepër, neni 41(6)(b)(iii) përcakton tri kategori krimesh të ardhshme lidhur me të cilët mund të lindë një rrezik relevant. Apel i KRASNIQIT përqendrohet vetëm në kategorinë e parë, në rrezikun se i akuzuari do ta “përsëritë veprën penale”.<sup>40</sup> Megjithatë,

---

<sup>36</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.35.

<sup>37</sup> Ndër të cilat edhe marrja parasysh e objektit dhe qëllimit të dispozitës. Për më tepër, interpretimi i të akuzuarit bie ndesh me parimin në lidhje me interpretimet e panevojshme, sipas të cilit asnjë dispozite nuk duhet t'i bëhet pa nevojë një interpretim që e bën atë të mos ketë efekt. Scalia and Garner, *Reading Law: The Interpretation of Legal Texts* (Thomson Reuters 2012), kapitulli 26.

<sup>38</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.38.

<sup>39</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.21.

<sup>40</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 35, 37.



Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk trajtoi posaçërisht vetëm atë kategori krimesh të ardhshme,<sup>41</sup> dhe as pjesa përkatëse e arsyetimit nuk kufizohet vetëm në to.<sup>42</sup>

23. Në fakt, ekzistojnë të gjithë treguesit se faktorët konkretë që mund të çojnë në lindjen e rrezikut sipas nenit 41(6)(b) lidhur me të akuzuarin – sikurse përshkruhen në vendim – nënkuptojnë më shumë se një kategori krimesh të mundshme në të ardhmen.<sup>43</sup> Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi ekzistencën e një “praktike” sjelljeje nga ana e të akuzuarit,<sup>44</sup> i cili – edhe në prill 2020 – i cilësoi personat që thjesht kanë thënë se disa pjesëtarë të UÇK-së kanë kryer krime, si “bashkëpunëtorë” në “shërbim të politikës së gjenocidit të Millosheviqit”.<sup>45</sup> Sikundër vihet në dukje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i akuzuari e ka bërë këtë “në dijeni të plotë” të kontekstit dhe pasojave të këtyre termave.<sup>46</sup> Si e tillë, sjellja e të akuzuarit kohët e fundit duhet të interpretohet logjikisht si një orvatje për të nxitur apo shtyrë dikë për kryerjen e krimeve kundër këtyre personave<sup>47</sup> dhe/ose si një kërcënim që tregon synimin e tij për të kryer krime në të ardhshmen.<sup>48</sup>

## B. VLERËSIMI ËSHTË INDIVIDUALIZUAR SI DUHET

<sup>41</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.21 (që i referohet në përgjithësi “arsyes së tretë” të nenit 41(6)(b)).

<sup>42</sup> Vendimi, KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 42, 43.

<sup>43</sup> Në veçanti, përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake është formuluar si konstatim se ekziston rreziku që i akuzuari “do të kryejë krime të tjera”. (Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.43).

<sup>44</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.42.

<sup>45</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.36, 42 (ku vihet në dukje pikëpamja e pandryshuar të akuzuarit lidhur me “bashkëpunëtorët”). *Shih gjithashtu* Përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim, KSC-BC-2020-06/F00153/RED, para. 25, që citon Kërkesën për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 6 (Shtojca 2, Pjesa II F, 24 prill 2020, postimi i Jakup Krasniqit në Facebook: “Çdo shqiptar që D. MARTIN e quan PATRIOT, qoftë në shërbim të kryeministrit apo kudo tjetër, është kolaboracionist e në shërbim të politikave gjenocidiste të [Slllobodan] MILLLOSHEVIQIT!”)

<sup>46</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 36, 42.

<sup>47</sup> Neni 41(6)(b)(iii) (“do të përfundojë një vepër penale në tentativë”).

<sup>48</sup> Neni 41(6)(b)(iii) (“do të kryejë një vepër penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë”).

24. Në këtë pjesë shtjellohet se përse arsyet 2-3 dhe 5 duhen refuzuar, ndërsa argumentet e tjera që rrjedhin nga këto arsye trajtohen në Pjesën C më poshtë.

25. Nuk kundërshtohet se vlerësimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake duhet bërë në bazë individuale, në dritën e rrethanave personale të secilit prej të akuzuarve.<sup>49</sup> Brenda vlerësimit të individualizuar dhe duke iu referuar një jurisprudence të gjerë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë dallim midis faktorëve individualë dhe atyre kontekstualë të rrezikut, si më poshtë:

Faktorët mund të jenë individualë, si për shembull, natyra dhe fushëveprimi i krimeve që pretendohet se janë kryer nga i akuzuari dhe dënimi i mundshëm me të cilin ai mund të përballlet, moshja e të akuzuarit, posti (postet) e mëparshme, profesioni, lidhjet familjare, gjendja shëndetësore, pasuria, sjellja dhe deklaratat e tij, kontaktet dhe lidhjet ndërkombëtare dhe ekzistenca e rrjeteve të përkrahjes që mund të lehtësojnë materializimin e një rreziku. Këta faktorë mund të jenë gjithashtu kontekstualë, si për shembull mjedisi dhe kushtet në të cilat jeton i akuzuari, apo faza përkatëse e procesit që është duke u kryer.

26. Ky dallim është i njëmendtë, sepse vetëm faktorët kontekstualë të rrezikut nuk janë të mjaftueshëm për të përligjur ekzistencën e rrezikut të nevojshëm për vazhdimin e paraburgimit.<sup>50</sup> Mbrojtja orvatet ta keqpërdorë këtë dallim, duke pretenduar se paraburgimi i të akuzuarit mbështetet vetëm në një numër të vogël faktorësh specifikë.<sup>51</sup>

27. Pësia e akuzave dhe ndëshkimet e mundshme që mund të jepen për to janë faktorë individualë të rrezikut. Konsiderata të tilla janë specifike për një individ të akuzuar dhe si pasojë janë konsideruar si faktorë individualë rreziku. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është mbështetur në krimet për të cilat janë ngritur akuzat dhe/ose në faktet materiale mbi të cilat ato mbështeten, për të provuar ekzistencën e të tre rreziqeve sipas nenit 41(6)(b).<sup>52</sup> Sikurse është shprehur Paneli, ata janë faktorë të rëndësishëm për t'u

<sup>49</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.19.

<sup>50</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.19.

<sup>51</sup> *Shih*, para.31më poshtë.

<sup>52</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 29, 36, 42.

marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit lidhur me domosdoshmërinë e paraburgimit në rrethanat e një çështjeje të caktuar.<sup>53</sup>

28. Profili politik i të akuzuarit dhe postet e mëparshme të tij janë gjithashtu konsiderata individuale mbi të cilat është mbështetur Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vlerësimin e tij.<sup>54</sup> Jakup KRASNIQI është ish-Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe ish-President në detyrë i Kosovës. Ai është gjithashtu ish-zëvendëskomandanti i UÇK-së. Një jetë e tërë me kontakte në UÇK dhe në qeveri nuk harrohen thjesht sepse ai ka dalë në pension. Ashtu si edhe të akuzuarit e tjerë në këtë çështje, KRASNIQI ka qasje në të njëjtin rrjet të gjerë përkrahësish me përvojë në fushat e sigurimit, policisë dhe zbulimit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë u ka dhënë peshë të konsiderueshme posteve drejtuese me ndikim që i akuzuari ka mbajtur në të kaluarën në UÇK dhe në qeverinë e Kosovës.

29. Rrjetet e përkrahësve që i akuzuari ka në dispozicion përbëjnë gjithashtu edhe një faktor rreziku që lidhet posaçërisht me atë person. Në lidhje me secilin prej rreziqeve sipas nenit 41(6)(b),<sup>55</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se i akuzuari ka qasje dhe mund të mobilizojë një rrjet përkrahësish. Ishte plotësisht e arsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të nxirrte përfundimin se ky rrezik e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit, duke pasur parasysh provat e shumta të ekzistencës së këtij rrjeti përkrahësish, të ndërhyrjeve aktive të ndërmarra tashmë prej tyre<sup>56</sup> dhe, sikurse vë në dukje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të qasjes dhe ndikimit të të akuzuarit mbi ta për shkak të profilit dhe posteve konkrete me pushtet që ka mbajtur në të kaluarën.

---

<sup>53</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.72.

<sup>54</sup> *Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED*, para. 29, 36, 42.

<sup>55</sup> *Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED*, para. 29, 36, 42.

<sup>56</sup> Botimi i dokumenteve konfidenciale të ZPS-së nga OVL-UÇK-ja tregon në veçanti motivimin dhe aftësinë e këtij rrjeti përkrahës dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tij me procedurat aktuale.

30. Mbrojtja e nënvlerëson dukshëm mundësinë e KRASNIQIT për të galvanizuar përkrahësit në Kosovë, duke u përpjekur ta paraqitë atë si një të pensionuar pa ndonjë ndikim.<sup>57</sup> Thirrjet e KRASNIQIT për ndëshkimin e bashkëpunëtoreve ishin zëdhënëse të ndërmarrjes kriminale të përbashkët të pretenduar kundër tij.<sup>58</sup> Deklaratat e tij publike të kohëve të fundit duhen kuptuar në këtë kontekst.<sup>59</sup> Që KRASNIQI ka qasje në një rrjet përkrahësish është e qartë nga atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë në gjykimet e ish-pjesëtarëve të UÇK-së, atmosferë që vijon të jetë e pranishme përmes veprimeve të OVL-UÇK-së dhe të tjerëve. T'i kërkohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake të përcaktojë apo identifikojë plotësisht të gjithë anëtarët e këtij rrjeti në rrethanat aktuale, është a paarsyeshme (në fakt, e pamundur);<sup>60</sup> Mbrojtja nuk jep asnjë precedent gjyqësor që të ketë kërkuar një specifikim të tillë, i cili nuk kërkohet madje as gjatë argumentimit të çështjeve në themel.<sup>61</sup>

31. Deklarimet e përsëritura të Mbrojtjes se paraburgimi i KRASNIQIT bazohet vetëm në postimet e tij në Facebook dhe [REDAKTUAR] keqinterpreton vendimin.<sup>62</sup> Secili prej konstatimeve të paraqitura më lart është konstatim rreziku mbi bazën e faktorëve individualë dhe specifikë që kanë të bëjnë me të akuzuarin dhe që, të marrë së bashku, do të ishin në vetvete më se të mjaftueshëm për të mbështetur domosdoshmërinë e paraburgimit të të akuzuarit.

<sup>57</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 29.

<sup>58</sup> [REDAKTUAR]. Përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim, KSC-BC-2020-06/F00153/RED, para.23, [REDAKTUAR].

<sup>59</sup> *Shih*, paragrafi 23 më sipër.

<sup>60</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 29.

<sup>61</sup> *STL, Prosecutor v. Ayyash*, STL-18-10/PT/TC, Decision on Alleged Defects in the Form of the Indictment, 28 shtator 2020, para. 51, 54(b) (nuk kërkohet që Prokuroria të identifikojë të gjithë bashkëkryesit, në veçanti kur identitetet e tyre nuk dihen). *Shih gjithashtu European Commission, A v. The Netherlands*, 15243/89, Vendim, 11 maj 1992, f.1, 5 (që e hedh poshtë si qartësisht të pabazuar kundërshtimin ndaj përshkrimit të përgjithshëm të akuzave, ku pretendohet ndër të tjera, se një i akuzuar kishte kryer një krim "së bashku dhe në lidhje me të tjerë apo me një tjetër, gjithsesi vetëm (në mënyrë të përsëritur)"); *ECtHR, Previti v. Italy*, 45291/06, Vendim, 8 dhjetor 2009, para.208.

<sup>62</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 29, 33, 40.

32. Së fundi, Mbrojtja argumenton në mënyrë të përsëritur se nuk ka prova të mjaftueshme për një lidhje midis veprimeve/sjelljes së të akuzuarit dhe faktorëve të rrezikut të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>63</sup> Sikundër është deklaruar më parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë ka ardhur në përfundimin se rreziqet mund të materializohen nga veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit, por nuk kërkojnë kryerje fizike nga ana e tij.<sup>64</sup> Në veçanti, faktorët kontekstualë shpesh janë me rëndësi dhe mund të merren parasysh.<sup>65</sup> Vendimi tregon qartë rëndësinë e faktorëve kontekstualë të cilët janë marrë parasysh.<sup>66</sup>

### C. FAKTORËT E TJERË TË RREZIKUT JANË PESHUAR NË MËNYRË TË SAKTË

33. Faktorët shtesë konkretë të rrezikut të kundërshtuar nga i akuzuari trajtohen më poshtë. Kjo pjesë u përgjigjet të gjithë argumenteve të tjerë në arsyet 2, 3 dhe 5 të Apelit të KRASNIQIT.

#### 1. Kohëzgjatja e paraburgimit

34. Nuk kishte asgjë të paligjshme dhe as të paarsyeshme në refuzimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për vlerësuar të kohëzgjatjes së gjithsejtë të pritshme të paraburgimit.<sup>67</sup>

35. Sigurisht, duke qenë se heqja e lirisë duhet të jetë gjithnjë proporcionale,<sup>68</sup> kohëzgjatja e paraburgimit është një faktor me rëndësi dhe mund të jetë arsye për lirim nëse një i akuzuar mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme kohe përpara fillimit të gjykimit të tij.<sup>69</sup> Megjithatë, dhe në ndryshim nga praktika në TPNJ,

<sup>63</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 29-31, 38.

<sup>64</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.22. *Shih*, paragrafi 18 më lart.

<sup>65</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.19 (dhe jurisprudenca e cituar në të).

<sup>66</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 38.

<sup>67</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.23.

<sup>68</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para.73.

<sup>69</sup> Rregulla 56(2).

paraburgimi në DHSK vlerësohet çdo dy muaj.<sup>70</sup> Prandaj, një vendim për paraburgim i marrë tani nuk dikton se për sa kohë do të mbahet në paraburgim një i akuzuar. Vlerësimi i kohëzgjatjes së ardhshme të paraburgimit nuk kërkohet në këtë fazë dhe, duke pasur parasysh kuadrin e zbatueshëm, nuk do ta avanconte shqyrtimin përkatës. Një vlerësim i tillë në fakt do të ishte i parakohshëm dhe hamendësues. Për më tepër, koha e fillimit të gjykimit është një çështje për të cilën palët kanë mospajtime të thella. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka bërë asnjë gabim të dukshëm kur refuzoi të vendoste për këtë çështje, dhe as kur nxori përfundimin se kohëzgjatja aktuale e paraburgimit të të akuzuarit deri tani, nuk ka krijuar ndonjë shqetësim lidhur me proporcionalitetin.

## 2. Nxjerrja në mënyrë progresive e provave

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri asnjë gabim të dukshëm kur u mbështet në faktin se i akuzuari informohet në mënyrë progresive për provat mbi të cilat mbështeten akuzat e ngritura ndaj tij, ndër të tjera edhe për identitetin e dëshmitarëve që kanë dhënë apo që mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që priten të paraqiten para DHSK-së.<sup>71</sup> Në fakt, jurisprudenca e paraqitur nga KRASNIQI, që sipas tij e kundërshton një nxjerrje të tillë, nuk e mbështet pretendimin se mbështetja në një faktor të tillë është e gabuar.<sup>72</sup>

37. Nëse paraburgimi bëhet më i domosdoshëm ose jo për shkak të informimit në mënyrë progresive të të akuzuarit për provat e ngritura kundër tij, është para së gjithash një çështje që vendoset nga paneli i shkallës më të ulët në bazë të diskrecionit të vet.<sup>73</sup>

<sup>70</sup> Rregulla 57(2).

<sup>71</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.32.

<sup>72</sup> Konkretisht, KRASNIQI jep: (i) një opinion mospajtues; (ii) një vendim për masa mbrojtëse, paragrafi i cituar i të cilit nuk bën ndonjë koment nëse nxjerrja në mënyrë progresive mund të rrisë rreziqet për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve; dhe (iii) një vendim të Dhomës së Apelit të vitit 2005 i cili nuk konstatoi asnjë gabim në refuzimin për ta shqyrtuar këtë faktor kur, ndryshe nga rasti aktual, nuk kishte prova se i akuzuari kishte kontaktet e nevojshme për të ushtruar ndikim ndaj dëshmitarëve.

<sup>73</sup> *Shih* ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Milutinoviçit e të tjerëve (Prosecutor v. Milutinović et al.)*, IT-05-87-AR65.2, Vendim mbi Apelin e ndërmjetëm lidhur me refuzimin e lirit të përkohshëm gjatë pushimit të dimrit

Duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i njeh më në hollësi provat si rezultat i procesit të konfirmimit, ai është më mirë në gjendje të vlerësojë se sa ndikon nxjerrja e mëtejshme e provave në motivet e të akuzuarit dhe, si pasojë, në rreziqet sipas nenit 41(6)(b). Në rastin konkret, informimi i të akuzuarit në mënyrë progresive lidhur me dëshmitarët që do të deponojnë kundër tij, në dritën e të gjithë faktorëve të tjerë relevantë, është parë si një aspekt që lidhet me rrezikun e ndërhyrjes tek ta.<sup>74</sup> Në këtë vlerësim nuk ka asnjë gabim të dukshëm;<sup>75</sup> i akuzuari thjesht shpreh mospajtimin e tij me mënyrën se si e ka përdorur diskrecionin Gjykatësi i Procedurës Paraprake .

### 3. Deklarata publike

38. Nëse opinionet e KRASNIQIT janë apo jo shprehje e lirisë së tij të fjalës nuk ka rëndësi për sa i takon vlerësimin të rrezikut sipas nenit 41(6)(b).<sup>76</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk vlerëson nëse këto deklaratime në vetvete janë vepra penale. Përkundrazi, ato janë me rëndësi për vlerësimin e rrezikut nëse KRASNIQI do të orvatet të pengojë drejtësinë, apo do të ndërhyjë tek dëshmitarët. Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet tek to vetëm për këtë qëllim, duke e bërë kështu të qartë se “çdo person ka të drejtë të shprehë opinionet e tij politike, duke përfshirë edhe ato që kritikojnë DHS-në.”<sup>77</sup> KRASNIQI nuk vë në dukje ndonjë gabim të dukshëm në këtë vlerësim.

---

(Interlocutory Appeal of Denial of Provisional Release During the Winter Recess), 14 dhjetor 2006, para.15 (në kontekstin që i akuzuari i dëgjoi provat kundër tij në mënyrë progresive gjatë gjykimit).

<sup>74</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.36.

<sup>75</sup> Përkundrazi, Dhoma e Apelit e ICC/GJPN-së miratoi shprehimisht mbështetjen te ky faktor në të njëjtën mënyrë. *Shih*, ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled “Decision on the ‘Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo’”, 26 tetor 2012 (‘Aktgjykimi i Apelit Gbagbo’), para. 65 (citimet janë hequr: “[...] Dhoma e Apelit vëren se Dhoma e Procedurës Paraprake ka konstatuar se nxjerrja e provave “amplifikonte” rrezikun ndaj hetimit dhe procedurave para gjykatës në rast të liritimit të z. Gbagbo. Për mendimin e Dhomës së Apelit, në këtë konstatim nuk ka asnjë gabim. Nxjerrja shton njohuritë e të paraburgosurit lidhur me hetimin e Prokurorisë. Rrjedhimisht, sipas nenit 58 (1)(b) (ii) të Statutit [që rregullon rrezikun e ndërhyrjes në GJPN], ai mund të jetë një faktor me rëndësi”).

<sup>76</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, arsyeja 2 (para.24), arsyeja 3 (para.28).

<sup>77</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 36.

39. Sigurisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në prova të tjera që shkojnë shumë më përtej deklaratave publike të të akuzuarit kundër DHSK-së. Për sa i takon nenit 41(6)(b)(iii), në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në konstatimet e tij, duke theksuar rrezikun e pengimit të procedurave, pozitën e rëndësishme të KRASNIQIT në Kosovë, pikëpamjet e tij të pandryshuara në lidhje me “bashkëpunëtorët” (si në lidhje me rolin e tij në të kaluarën në UÇK ashtu edhe me komentet e tij të kohëve të fundit) dhe kontekstin e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.<sup>78</sup>

#### 4. Akuzat e paraqitura në Aktakuzë

40. Ky Panel nuk ka gjetur asnjë gabim lidhur me mbështetjen tek akuzat e paraqitura nga ZPS-ja gjatë vlerësimit të rrezikut të pengimit të procedurave gjyqësore.<sup>79</sup> Nuk ka asnjë tregues se ky faktor është marrë për bazë i shkëputur nga të tjerët; përkundrazi, ai ishte një prej disa faktorëve mbi të cilët u mbështetën konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Në kundërshtim me argumentet e të akuzuarit, vlerësimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk pati asnjë ndikim në prezumimin e pafajësisë së tij.<sup>80</sup> Çështja e shtruar për shqyrtim këtu është vetëm vlerësimi i rreziqeve dhe gjasave—Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka bërë vlerësim nëse i akuzuari është fajtor për ndonjë krim sipas juridiksionit të DHSK-së. Këto akuza janë përdorur më shumë si bazë për të bërë vlerësimin e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b). Dhe kjo ishte e arsyeshme, duke pasur parasysh konstatimin ekzistues se, ndër arsye të tjera, ekziston një dyshim i mirëbazuar që i akuzuari i ka kryer krimet që pretendohen nga ZPS-ja.

#### 5. [REDAKTUAR]

<sup>78</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 42. KRASNIQI nuk i identifikon të gjithë faktorët e shqyrtuar kur pretendon se “është plotësisht e paarsyeshme të konstatohet se këto çështje demonstrojnë një rrezik të mjaftueshëm që z. Krasniqi do të kryejë krime të rënda”. *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.39.

<sup>79</sup> *Vendimi i apelit të Gucatit*, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 60-63.

<sup>80</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, arsyeja 2 (para. 22, 25), arsyeja 3 (para. 27).



41. I akuzuari thjesht shpreh mospajtim me peshën që u është dhënë [REDAKTUAR] dhe nuk identifikon asnjë gabim të dukshëm në përdorimin e tyre nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>81</sup> Në të vërtetë, i akuzuari është ai që nuk e vlerëson rëndësinë [REDAKTUAR].

42. Gjatë [REDAKTUAR].<sup>82</sup> [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR].

43. [REDAKTUAR].<sup>83</sup>

[REDAKTUAR].

[REDAKTUAR].

[REDAKTUAR].<sup>84</sup>

44. [REDAKTUAR].<sup>85</sup> [REDAKTUAR].<sup>86</sup> [REDAKTUAR],<sup>87</sup> [REDAKTUAR]. Këmbëngulja e Mbrojtjes se vendimi i Gjykatësit i Procedurës Paraprake duhet të bazohet mbi atë nëse KRASNIQI ishte përfshirë faktikisht në ndërhyrje [REDAKTUAR], ngatërron ndërhyrjen konkrete me rrezikun e ndërhyrjes, dhe përsëri keqinterpreton natyrën e vlerësimit të lirit të përkohshëm.

45. Në fakt, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes,<sup>88</sup> nuk ka absolutisht asnjë mospërputhje midis konstatimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në vendimin e kundërshtuar dhe në vendimin e tij të mëparshëm për autorizimin [REDAKTUAR]. Në vendimin e tij të mëparshëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se nuk kishte prova se KRASNIQI kishte bërë përpjekje për të ndërhyrë në administrimin e

<sup>81</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 30-31.

<sup>82</sup> Përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim, KSC-BC-2020-06/F00153, para. 26, që citon [REDAKTUAR].

<sup>83</sup> *Shih në përgjithësi* [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

<sup>84</sup> Përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim, KSC-BC-2020-06/F00153, para.27, që citon [REDAKTUAR].

<sup>85</sup> *Shih*, [REDAKTUAR].

<sup>86</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180, para.36.

<sup>87</sup> Kundërpërgjigjja e KRASNIQIT lidhur me kërkesën për lirim, KSC-BC-2020-06/F00163, para. 8, 12-13.

<sup>88</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.31.

drejtësisë.<sup>89</sup> Por vlerësimi në atë vendim kishte të bënte vetëm me konstatimin e rrezikut se KRASNIQI do të ndërhynte. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk nxori përfundimin – dhe në kontekstin e lirimit të përkohshëm nuk kishte pse të nxirrte këtë përfundim – se KRASNIQI i kishte penguar më parë procedurat gjyqësore.<sup>90</sup>

#### D. ASNJË KUSHT NUK I ZVOGËLON MJAFTUESHËM RREZIQET E IDENTIFIKUARA

46. Së fundi, arsyeja 6 e apelit të KRASNIQIT është e pabazë, sepse mbështetet në shtrembërimin e konstatimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoi se asnjë nga kushtet e propozuara dhe asnjë nga kufizimet shtesë që mund të vendoseshin prej tij, nuk do të mund të kufizonin mundësitë e të akuzuarit për të komunikuar me komunitetin apo me rrjetin përkrahës të tij.<sup>91</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se rreziqet ishin të tilla që mund të menaxhoheshin si duhet me anë të një mjedisi plotësisht të kontrolluar, të cilin vetëm paraburgimi mund ta sigurojë.<sup>92</sup> Duket qartë se mundësia e zvogëlimit të mjaftueshëm të secilit prej rreziqeve të identifikuar sipas nenit 41(6)(b) është shqyrtuar me kujdes.<sup>93</sup> Nuk ka asnjë gabim të dukshëm në këtë konstatim.

48. Megjithëse i akuzuari ka bërë më parë nxitje të drejtpërdrejta,<sup>94</sup> ai është gjithashtu plotësisht në gjendje të bëjë deklarata me thirrje të tërthorta dhe të nënkuptuara për ndërhyrje.<sup>95</sup> Nuk ka asnjë gabim në shqetësimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se

<sup>89</sup> Version i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të vendimit për kontrollim dhe sekuestrim, KSC-BC-2020-06/F00031/CORR/RED, para.25.

<sup>90</sup> [REDAKTUAR].

<sup>91</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.49.

<sup>92</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.49.

<sup>93</sup> Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para. 48-49. *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.43.

<sup>94</sup> *Shih*, paragrafi 23 më lart.

<sup>95</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.42.

deklaratat publike lidhur me tema që nuk kanë të bëjnë me këtë çështje mund t'i shtojnë rreziqet e identifikuar në nenin 41(6)(b).

49. Vendimi nuk përfshin ndonjë konstatim se i akuzuari duhet të mbahet në paraburgim “thjesht për shkak të mundësisë së tij për të pasur komunikime private”.<sup>96</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake i peshoi të gjithë faktorët relevantë të marrë së bashku.<sup>97</sup> Duke marrë parasysh postet e mëparshme me pushtet të KRASNIQIT në UÇK dhe në qeveri, deklaratat publike të tij, atmosferën e frikësimit dhe faktorë të tjerë të identifikuar, mundësia e KRASNIQIT për të kryer biseda private bëhet një rrezik i pamenaxhueshëm.

50. Çdo përpjekje për të propozuar kushte të cilat kufizojnë më tej telefonatat dhe deklaratat publike<sup>98</sup> nuk merr parasysh realitetin mbi të cilin mbështeten konsideratat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mënyra kryesore me të cilën i akuzuari do të jetë në gjendje të ndërhyjë ose të kryejë krime të tjera është nëpërmjet dërgimit të mesazheve ish-vartësve dhe përkrahësve të tij.<sup>99</sup> Komunikimet e të akuzuarit janë mënyra nëpërmjet së cilës do të realizohen rreziqet e identifikuar dhe për këtë arsye, kontrolli dhe monitorimi i tyre është një aspekt i qenësishëm i paraburgimit të tij.

51. Për sa i takon gatishmërisë së policisë së Kosovës për të garantuar zbatimin e kushteve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shpreh apo supozon asgjë lidhur me këtë pikë.<sup>100</sup> Nëse asnjë kusht nuk mund t'i zvogëlojë rreziqet e identifikuar, paneli nuk është i detyruar të vlerësojë gatishmërinë dhe aftësinë e një shteti për t'i zbatuar kushtet.<sup>101</sup> Ka prova të konsiderueshme se autoritetet e Kosovës kanë mundësi të kufizuara për të monitoruar një të akuzuar me përmasat, burimet, dhe autoritetin e KRASNIQIT në një çështje si kjo.<sup>102</sup> Megjithatë, duke pasur parasysh konstatimin e Gjykatësit të Procedurës

<sup>96</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.44.

<sup>97</sup> *Shih*, Vendimi KSC-BC-2020-06/F00180/RED, para.19.

<sup>98</sup> Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para. 41-44.

<sup>99</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.42.

<sup>100</sup> *Shih*, Apeli i KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/IA002-F00001, para.43.

<sup>101</sup> Aktgjykimi i Apelit *Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, para. 80.

<sup>102</sup> Përgjigjja e ZPS-së ndaj kërkesës për lirim, KSC-BC-2020-06/F00153/RED, para. 37-43.

Paraprake se rreziqet e identifikuara nuk mund të menaxhohen përmes asnjë kushti, gatishmëria për të zbatuar kushtet bëhet faktor i parëndësishëm. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka bërë ndonjë gabim të dukshëm në këtë pikë.

## V. Përfundim

52. Për arsyet e mësipërme, Paneli duhet ta refuzojë Apelin e KRASNIQIT në tërësinë e vet.

**Numri i fjalëve: 4,892**

/nënshkrimi/

---

**Xhek Smith**  
**Prokurori i Specializuar**

E premte, 19 shkurt 2021  
Hagë, Holandë.